



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Shtojca 14

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[08.01.2024]

Drejtuar: “FILARA” shpk

Adresa: Rruga e Kavajës, ish Kombinati "Misto Mame", pranë fabrikës "Kaon", Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedure e hapur e Thjeshtuar” Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “Shërbim brandimi për zyrat e “Identitek” SHA” me fond limit të marrëveshjes kuadër në vlerën prej: 2,402,000 (dy milion e katërqind e dy mijë) Lekë (pa TVSH) dhe me nr.REF-89706-12-05-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Procedure e hapur e Thjeshtuar” Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “**Shërbim brandimi për zyrat e “Identitek” SHA**” me fond limit të marrëveshjes kuadër në vlerën prej: **2,402,000** (dy milion e katërqind e dy mijë) **Lekë (pa TVSH)** dhe me nr.**REF-89706-12-05-2023**. Afati i marrëveshjes kuadër: 1 (një) vit.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 29.12.2023,Nr.105*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “ALBDESIGN PSP” shpk NIPT: L51819005Q

Vlera e ofruar: Nuk ka paraqitur ofertë

2. “FILARA” shpk NIPT: K51611059N

Vlera e ofruar: 2,088,900 (dymilion e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) Lekë pa TVSH

Adresa: Rruga “Xhanfize Keko” Ish Topografia Ushtarake, Tiranë

3. **“HASAN ZANE” person fizik** **NIPT: L61415511N**
Vlera e ofruar: 1,885,000 (*njëmilion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë*) Lekë pa TVSH
4. **“START REKLAMA” shpk** **NIPT: L32228074P**
Vlera e ofruar: 2,290,000 (*dymilion e dyqind e nëntëdhjetë mijë*) Lekë pa TVSH
5. **“UNIVERS REKLAMA” shpk** **NIPT: K41926003N**
Vlera e ofruar: 1,920,650 (*njëmilion e nëntëqind e njëzet mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë*) Lekë pa TVSH

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. **“ALBDESIGN PSP” shpk** **NIPT: L51819005Q**

Arsyet e skualifikimit:

- Nuk është dorëzuar as ofertë dhe as dokumentacion në përmbushje të kërkesave kualifikuese. Janë dorëzuar vetëm 3 (tre) file (i njëjti dokument i hedhur tre herë), konkretisht ISO 90001, dokument që nuk është kërkuar në kriteret e publikuara.

Për këto arsye, në vijim të mospërmbushjes së kriterëve kualifikuese dhe konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta e këtij operatori ekonomik është refuzuar (skualifikuar).

2. **“START REKLAMA” shpk** **NIPT: L32228074P**

Arsyet e skualifikimit:

- Nuk janë paraqitur pasqyrat financiare (bilancet) e viteve 2020 dhe 2021, ndërsa bilanci i paraqitur i vitit 2022 është i pa certifikuar nga organet tatimore, duke mos përmbushur përcaktimet e pikës 2 të Kapacitetit ekonomik e financiar të kriterëve kualifikuese.
- Mungon përmbajtja e deklaratës së kërkuar në pikën 4 të Kapacitetit teknik të kriterëve kualifikuese mbi përdorimin e bojrave ekologjike dhe rezistente ndaj faktorëve atmosferikë. Është paraqitur dy herë përmbajtja e deklaratës së garancisë.

Për këto arsye, në vijim të mospërmbushjes së kriterëve kualifikuese dhe konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta e këtij operatori ekonomik është refuzuar (skualifikuar).

3. **“UNIVERS REKLAMA” shpk** **NIPT: K41926003N**

Arsyet e skualifikimit:

- Oferta e paraqitur (formulari i ofertës) përmban një zë shtesë (konkretisht transport e montim), kostoja e të cilit do të duhej të përfshihej në koston e materialeve dhe artikujve. Ndryshimi i tabelës së publikuar në DST dhe paraqitja veçmas e koston së montimit e transportit, në

procedurën konkrete të marrëveshjes kuadër, paraqet pamundësi të llogaritjes së vlerës për secilin nga artikujt në momentin e porosisë.

Konkretisht, në marrëveshjen kuadër, autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të porosisë të gjithë sasinë që është parashikuar, pasi për të gjithë artikujt dhe në periudha të ndryshme porosit sasi të ndryshme në zëra artikujsh sipas nevojës. Për këtë asrye, llogaritja e vlerës së secilit artikull, përfshirë transport e montim, është e pamundur.

- Pasqyra financiare (bilanci) i paraqitur i vitit 2022 është i pa certifikuar nga organet tatimore, duke mos përmbushur përcaktimet e pikës 2 të Kapacitetit ekonomik e financiar të kriterëve kualifikuese. Gjithashtu të tre bilancet e viteve 2020, 2021 dhe 2022, nuk rezulton të jenë të shoqëruara me raport auditimi ligjor, sikundër kërkuar në kerkesën kualifikuese, duke qenë se plotësohen minimalisht dy nga tre kushtet e përcaktuara në nenin 41 të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009.

Për këto arsye, në vijim të mospërmbushjes së kriterëve kualifikuese dhe konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta e këtij operatori ekonomik është refuzuar (skualifikuar).

4. “HASAN ZANE” person fizik NIPT: L61415511N

Arsyet e skualifikimit:

Pas kualifikimit paraprak dhe renditjes në vend të parë, këtij operatori iu kërkuar të paraqesë dokumentacionin provues të vetëdeklarimeve sipas shojcës 8. Referuar dokuemntacionit shkresor të dorëzuar më datë 22.12.2023, konstatohet se:

- Nuk është paraqitur dokumentacion shkresor, në përmbushje të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, që vërteton punësimin e të paktën 3 (tre) punonjësve, konkretisht kontrata të rregullta punësimi etj, duke mos përmbushur përcaktimet e pikës 2 të Kapacitetit ekonomik e financiar të kriterëve kualifikuese.
- Nuk është paraqitur dokumentacion shkresor bindës, në përmbushje të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, që vërteton disponimin realisht të të paktën 2 (dy) makinerive të printimit, duke mos përmbushur përcaktimet e pikës 3 të Kapacitetit ekonomik e financiar të kriterëve kualifikuese. Është paraqitur vetëm një akt-marrëveshje e thjeshtë mbi marrjen në përdorim të tyre nga një subjekt i tretë, por pa paraqitur asnjë dokument tjetër mbështetës për vërtetuar nëse edhe ky subjekt i ka apo i disponon realisht këto pajisje.

Për këto arsye, në vijim të mospërmbushjes së kriterëve kualifikuese dhe konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta e këtij operatori ekonomik është refuzuar (skualifikuar).

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. “FILARA” shpk

NIPT: K51611059N

Vlera e ofruar: 2,088,900 (*dymilion e tetëdhjetë e tetëmijë e nëntëqind*) Lekë pa TVSH.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek “Identitek” SHA me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR